

PHILIPS

HD928X

Manuali i përdorimit

TABELA E PËRMBAJTJES

E rëndësishme	3
Hyrje	9
Përshkrim i përgjithshëm	9
Përpara përdorimit të parë	10
Programi NutriU	10
Kontrolli me zë	11
Përgatitja për përdorim	11
Përdorimi i pajisjes	12
Tryeza e ushqimit	12
Skuqja me ajër	13
Zgjidhni modalitetin e mbajtjes ngrohtë	17
Gatimi me presete	18
Kalimi në preset tjetër	20
Nisja e një recete nga programi NutriU	20
Skuqja e patateve të shtëpisë	21
Pastrimi	22
Tryeza e pastrimit	23
Vendruajtja	23
Riciklimi	24
Deklarata e konformitetit	24
Garancia dhe mbështetja	24
Përditësimet e softuerit	24
Përputhshmëria e pajisjes	25
Rikthimi në parametrat e fabrikës	25
Zgjidhja e problemeve	25

E rëndësishme

Lexoni me kujdes këtë informacion të rëndësishëm përpara se ta vini në punë pajisjen dhe ruajeni për referencë në të ardhmen.

Rrezik

- Mos e zhytni kurrë pajisjen në ujë dhe as mos e shpëlani në çezmë.
- Mos lejoni futjen e ujit ose të ndonjë lëngu tjetër brenda në pajisje, për të shmangur goditjen elektrike.
- Gjithmonë futini përbërësit për skuqje brenda koshit, për të parandaluar kontaktin e tyre me rezistencat e nxehjes.
- Mos i mbuloni vrimat e hyrjes dhe të daljes së ajrit ndërkohë që pajisja është duke punuar.
- Mos e mbushni tiganin me vaj pasi ky veprim mund të përbëjë rrezik për zjarr.
- Mos e përdorni pajisjen nëse spina, kordoni elektrik ose vetë pajisja është e dëmtuar.
- Mos e prekni kurrë pjesën e brendshme të pajisjes ndërkohë që është duke punuar.
- Mos futni kurrë sasi më të madhe ushqimi sesa niveli maksimal që tregohet te koshi.
- Gjithmonë sigurohuni që nxehësi është i lirë dhe brenda tij nuk ka ngecur asnjë ushqim.

Paralajmërim

- Nëse kordoni elektrik është i dëmtuar, ai duhet ndërruar nga "Philips", agjenti i tij i servisit apo persona me kualifikim të ngjashëm, në mënyrë që të shmangen rreziqet.
- Pajisjen lidheni vetëm me priza të tokëzuara. Sigurohuni gjithnjë që spina të futet siç duhet në prizë.
- Kjo pajisje nuk është menduar të vihet në përdorim me anë të një kohëmatësi të jashtëm apo një sistemi të veçantë për komandimin nga distanca.



- Sipërfaqet e arritshme mund të nxehen gjatë përdorimit.
- Kjo pajisje mund të përdoret nga fëmijë të moshës 8 vjeç e lart dhe nga persona me aftësi të kufizuara fizike, ndijuese ose mendore, apo që kanë mungesë përvojë dhe njohurish vetëm nëse ata mbikëqyren ose udhëzohen për përdorimin e sigurt të pajisjeve dhe nëse kuptojnë rreziqet e përfshira. Fëmijët nuk duhet të luajnë me pajisjen. Pastrimi dhe mirëmbajtja nga përdoruesi nuk duhen kryer nga fëmijët, përveç nëse janë më të mëdhenj se 8 vjeç dhe nën mbikëqyrje.
- Mbajeni pajisjen dhe kordonin larg vendeve ku mund të arrihet nga fëmijët e moshës nën 8 vjeç.
- Mos e mbështetni pajisjen në mur ose në pajisje të tjera. Lini të paktën 10 cm hapësirë të lirë në pjesën e pasme, në të dyja anë e pajisjet dhe sipër saj. Mos vendosni asgjë mbi pajisje.
- Gjatë skuqjes me ajër të nxehtë del avull i nxehtë nga vrimat e daljes së ajrit. Mbani duart dhe fytyrën në distancë të sigurt larg avullit dhe vrimave të daljes së ajrit. Gjithashtu tregohuni të kujdesshëm për avullin e nxehtë kur nxirrni tiganin nga pajisja.
- Mos përdorni kurrë përbërës të lehtë ose letër paketimi në pajisje.
- Ruajtja e patateve: Temperatura duhet të jetë e përshtatshme për varietetin e patates që ruhet dhe ajo duhet të jetë mbi 6°C për të minimizuar rrezikun e ekspozimit të akrilamidit në ushqimet e përgatitura.
- Mos e vendosni pajisjen mbi apo pranë një stufe të nxehtë me gaz apo mbi të gjitha

llojet e stufave elektrike dhe pianurave elektrike ose në një furrë të nxehtë.

- Mos hidhni kurrë vaj në tigan.
- Kjo pajisje është projektuar për t'u përdorur në temperaturë ambienti midis 5°C dhe 40°C.
- Përpara se ta vini në punë pajisjen kontrolloni nëse tensioni i treguar në pajisje përkon me tensionin e rrjetit elektrik lokal.
- Mbajeni kordonin elektrik larg sipërfaqeve të nxehta.
- Mos e vendosni pajisjen mbi apo pranë materialeve që marrin flakë, si për shembull mbulesë tavoline ose perde.
- Mos e përdorni pajisjen për asnjë qëllim tjetër përveç atij të përshkruar në këtë manual dhe përdorni vetëm aksesore origjinalë të Philips.
- Mos e lini pajisjen në punë pa mbikëqyrje.
- Tigani, koshi dhe reduktuesi i yndyrës nxehen gjatë përdorimit të pajisjes dhe janë të nxehtë edhe pas përdorimit të saj, kështu që veproni me kujdes.
- Përpara se ta përdorni pajisjen për herë të parë, pastrojini mirë pjesët që bien në kontakt me ushqimin. Referojuni udhëzimeve në manual.

Kujdes

- Kjo pajisje është parashikuar vetëm për përdorim të zakonshëm në shtëpi. Ajo nuk është menduar për përdorim në ambiente si kuzhinat profesionale apo dyqane, zyra, ferma ose ambiente të tjera pune. Ajo as nuk është menduar për përdorim nga klientët në hotele, motele, ambiente për fjetje dhe mëngjes dhe mjedise të tjera banimi.
- Shkëputeni gjithmonë pajisjen nga priza nëse e lini të pamonitoruar dhe përpara se

ta montoni, çmontoni, ta vendosni në ruajtje ose përpara se ta pastroni.

- Vëreni pajisjen mbi një sipërfaqe horizontale, të drejtë dhe të qëndrueshme.
- Nëse pajisja përdoret në mënyrë të papërshtatshme apo për qëllime profesionale ose gjysmë-profesionale apo nuk përdoret sipas udhëzimeve në këtë manual përdorimi, garancia bëhet e pavlefshme dhe "Philips" refuzon çdo lloj përgjegjësie për dëmin e shkaktuar.
- Gjithmonë dërgojeni pajisjen në pikë servisi të autorizuar nga Philips për kontroll ose riparim. Mos tentoni ta riparoni vetë pajisjen, përndryshe garancia bëhet e pavlefshme.
- Hiqeni gjithnjë pajisjen nga priza pas përdorimit.
- Lëreni pajisjen të ftohet për rreth 30 minuta përpara se ta përdorni apo ta pastroni atë.
- Sigurohuni që përbërësit e përgatitur në këtë pajisje të dalin në ngjyrë të verdhtë të artë në vend të një ngjyre të verdhë të errët apo ngjyrë kafe. Largoni mbetjet e djegura. Mos skuqni patate të freskëta në temperaturë mbi 180°C (për të minimizuar krijimin e akrilamidit).
- Mos shtypni butonin e lëshimit të shportës gjatë lëkundjes.
- Bëni kujdes kur pastroni pjesën e sipërme të dhomës së gatimit: rezistenca e nxehtë, skajet e pjesëve metalike.
- Sigurohuni gjithmonë që ushqimi në fritezën me ajër është skuqur plotësisht.
- Sigurohuni gjithmonë që keni nën kontroll fritezën me ajër, edhe kur përdorni funksionin e kontrollit nga largësia ose nisjen e vonuar.

- Kur gatuani ushqime me yndyrë, nga friteza me ajër mund të dalë tym. Tregoni kujdes të veçantë kur përdorni funksionin e kontrollit nga largësia ose nisjen e vonuar.
- Sigurohuni që funksioni i kontrollit nga largësia të përdoret vetëm nga një person në çdo rast.
- Bëni kujdes kur gatuani ushqime që prishen shpejt kur përdorni funksionin e nisjes së vonuar (mund të krijohen baktere).


Fushat elektromagnetike (EMF)

Kjo pajisje "Philips" është në përputhje me të gjitha standardet dhe rregulloret e zbatueshme lidhur me fushat elektromagnetike.

Fikja automatike

Kjo pajisje është e pajisur me një funksion fikjeje automatike. Nëse nuk shtypni një buton brenda 20 minutave, pajisja fiket automatikisht. Për ta fikur manualisht pajisjen, shtypni butonin e ndezjes/fikjes.

8 SHQIP



Hyrje

Urime për blerjen dhe mirë se vini te Philips!

Për të përfituar plotësisht nga mbështetja që ofron Philips, regjistroni produktin në faqen **www.philips.com/welcome**.

Philips Airfryer është friteza e vetme me ajër me teknologjinë unike Rapid Air për skuqjen e ushqimeve tuaja të preferuara me pak apo aspak vaj dhe me deri në 90% më pak yndyrë.

Teknologjia Philips Rapid Air e gatuan ushqimin në tërësi si dhe dizajni ynë në formë ylli deti për rezultate perfekte nga kafshata e parë deri tek e fundit.

Mund të shijoni një ushqim të skuqur më së miri – krokante nga jashtë dhe i butë nga brenda – me skuqje, skarë dhe pjekje për të përgatitur një larmi gatimesh të shijshme në një mënyrë të shëndetshme, të shpejtë dhe të lehtë.

Për më shumë frymëzim, receta dhe informacion për fritezën me ajër, vizitoni **www.philips.com/kitchen** ose shkarkoni programin NutriU* falas për IOS® ose Android™.

* Programi NutriU mund të mos ofrohet në shtetin ku ndodheni.

Në këtë rast jeni të lutur të hapni faqen vendore të internetit të Philips për frymëzim.

Përshkrim i përgjithshëm

- 1 Paneli i kontrollit
 - A Butoni i rritjes së temperaturës
 - B Butoni i uljes së temperaturës
 - C Butoni i menysë
 - D Meny të e preseteve
 - E Butoni i ndezjes/fikjes
 - F Butoni i uljes së kohës
 - G Butoni i rritjes së kohës
 - H Treguesi i kohës
 - I Ekrani
 - J Treguesi i temperaturës
 - K Treguesi i Wi-Fi
- 2 Treguesi MAX
- 3 Koshi
- 4 Butoni i lirim të koshit
- 5 Tigani
- 6 Kordoni elektrik
- 7 Vrimat e daljes së ajrit
- 8 Hyrja e ajrit

Statusi i treguesit të Wi-Fi	
Treguesi i Wi-Fi  është i fikur	Ose friteza juaj me ajër nuk është e lidhur me Wi-Fi e shtëpisë (nuk është kryer ndonjë konfigurim fillestar i Wi-Fi deri tani), ose lidhja me Wi-Fi e shtëpisë ka rënë për shkak p.sh. se rrugëzuesi ka ndryshuar ose distanca mes fritezës me ajër dhe rrugëzuesit është shumë e madhe
Treguesi i Wi-Fi  është i ndezur	Konfigurimi me programin NutriU është kryer dhe friteza me ajër është lidhur me Wi-Fi të shtëpisë
Treguesi i Wi-Fi  pulson	Ose friteza me ajër është në modalitet "konfigurimi" gjatë procesit të "konfigurimit" të Wi-Fi. Ekranin tregon tre viza dhe butonat në fritezën me ajër janë joaktive; ose nëse ishte lidhur që më parë, llamba pulsuese është tregues se friteza është në proces lidhjeje me Wi-Fi e shtëpisë.
Treguesi i Wi-Fi  pulson me pushim të gjatë ndërmjet	Funksioni i Wi-Fi i fritezës ka defekt. Ose mund ta përdorni fritezën me ajër pa funksionet e lidhjes, ose mund të telefononi linjën e shërbimit të Philips, ose të kontaktoni me qendrën shërbimit të klientit për shtetin ku ndodhëni.

Përpara përdorimit të parë

- 1 Hiqni të gjithë materialin e paketimit.
- 2 Hiqni ngjitëset ose etiketat (nëse ka) nga pajisja.
- 3 Pastrojeni mirë pajisjen përpara përdorimit të parë, siç tregohet në kapitullin e pastrimit.

Programi NutriU

Friteza juaj me ajër Philips mbështet Wi-Fi dhe mundëson lidhjen me NutriApp për një përdorim më të gjerë të fritezës. Brenda programit mund të zgjidhni recetat e preferuara, t'ia dërgoni fritezës dhe ta ndizni nga pajisja juaj inteligjente. Mund ta ndizni, monitoroni dhe rregulloni procesin e gatimit në pajisjen tuaj inteligjente kudo ku ndodhëni, edhe nëse nuk jeni në shtëpi.

Lidhja e fritezës me ajër me programin

- 1 Futeni fritezën me ajër në prizë.
- 2 Sigurohuni që pajisja juaj inteligjente të jetë brenda rrezes së rrjetit Wi-Fi të shtëpisë përpara se të filloni procesin e konfigurimit të lehtë të Wi-Fi.
- 3 Shkarkoni programin Philips NutriU në pajisjen tuaj inteligjente nga dyqani i programeve ose nga www.philips.com/nutriu, ndiqni procesin e regjistrimit dhe zgjidhni fritezën e lidhur me ajër në profilin tuaj të "My Appliances".
- 4 Ndiqni udhëzimet në program për ta lidhur fritezën me Wi-Fi dhe për të çiftuar fritezën.
- 5 Kur llamba e Wi-Fi në ndërfaqen e përdorimit të fritezës të jetë ndezur konstante, friteza është e lidhur.

Shënim

- Sigurohuni që ta lidhni fritezën me një rrjet Wi-Fi shtëpie 2,4 GHz 802.11 b/g/n.
- Konfigurimi i lehtë i Wi-Fi nevojitet për ta lidhur fritezën me Wi-Fi e shtëpisë.
- Procesi i çiftimit është për të lidhur programin NutriU me fritezën tuaj inteligjente.
- Procesi i konfigurimit të Wi-Fi mund të anulohet nëpërmjet programit ose duke e hequr fritezën nga priza.
- Mund të çiftoni vetëm një pajisje inteligjente për rast me fritezën. Nëse një përdorues i dytë fillon procesin e çiftimit, përdoruesi i parë nxirret jashtë dhe duhet ta çiftojë sërish herën tjetër kur të gatuarë me fritezën.
- Për të nisur procesin e çiftimit, shtypni gjatë butonin e uljes së temperaturës dhe ndiqni udhëzimet në program ose niseni nga cilësimet në programin NutriU.

Kontrolli me zë

- 1 Shkarkoni programin NutriU.
- 2 Lidheni programin NutriU me fritezën.
- 3 Jepni pëlqimin për "remote cooking".
- 4 Lidhni programin NutriU me programin tuaj të asistentit zanor. Kjo lidhje mund të kryhet drejtpërdrejt gjatë hapave të parë ose më vonë të cilësimit të programit NutriU. Në rast se nuk e shihni opsionin për të aktivizuar kontrollin zanor në vetë NutriU, aktivizoni aftësinë Kitchen+ përmes programit tuaj të asistentit zanor.

Shënim


- Nëse nuk keni programin kontrolli zanor, shkarkojeni përpara për të dërguar komanda drejt fritezës.
- Komandat e detajuara zanore ofrohen në program për kontroll zanor.

Përgatitja për përdorim

- 1 Vëreni pajisjen mbi një sipërfaqe të qëndrueshme, horizontale, të rrafshët dhe rezistente ndaj nxehtësisë.

Shënim

- Mos vendosni asgjë sipër ose në anët e pajisjes. Kjo mund të ndërpresë rrjedhën e ajrit dhe të ndikojë në rezultatin e skuqjes.
- Mos e vendosni pajisjen e ndezur pranë apo poshtë objekteve që mund të dëmtohen nga avulli, si muret dhe dollapët.
- Lëreni tapën e gomës në tigan. Mos e hiqni përpara gatimit.



Përdorimi i pajisjes

Tryeza e ushqimit

Tryeza më poshtë ju ndihmon të zgjidhni cilësimet bazë për llojet e ushqimit që dëshironi të përgatisni.



Shënim

- Vini re se këto cilësime janë sugjerime. Duke qenë se përbërësit ndryshojnë në origjinë, madhësi, formë, si dhe markë, ne nuk mund të garantojmë cilësimin optimal për përbërësit tuaj.
- Kur përgatisni sasi të mëdha ushqimi (p.sh. patate, karkaleca, kofshë pule, ushqime të ngrira), tundini, kthejini ose trazojini përbërësit në kosh 2 a 3 herë për të arritur rezultate të njëtrajtshme.

Përbërësit	Sasia min.–maks.	Ora (min)	Temperatura	Shënim
Patate të holla të ngrira (7x7 mm/0.3x0.3 in)	200-800 g / 7-28 oz	14-31	180°C/350°F	• Tundini, kthejini ose trazojini 2-3 herë ndërmjet
Patate të skuqura shtëpie (10x10 mm/0.4x0.4 in trashësi)	200-800 g / 7-28 oz	20-40	180°C/350°F	• Tundini, kthejini ose trazojini 2-3 herë ndërmjet
Kroketa të ngrira pule	200-600 g/ 7-21 oz	9-20	200°C/400°F	• Tundini, kthejini ose trazojini deri në gjysmë
Role të ngrira	200-600 g/ 7-21 oz	9-20	200°C/400°F	• Tundini, kthejini ose trazojini deri në gjysmë
Hamburger (rreth 150 g/5 oz)	1-5 qofte	16-21	200°C/400°F	
Copë mishi	1200 g / 42 oz	55-60	150°C/300°F	• Përdorni aksesoren e pjekjes
Thela mishi pa kockë (rreth 150 g/5 oz)	1-4 thela	15-20	200°C/400°F	• Tundini, kthejini ose trazojini deri në gjysmë
Salsiçe të holla (rreth 50 g/1.8 oz)	2-10 copë	11-15	200°C/400°F	• Tundini, kthejini ose trazojini deri në gjysmë
Kofshë pule (rreth 125 g/4.5 oz)	2-8 copë	17-27	180°C/350°F	• Tundini, kthejini ose trazojini deri në gjysmë
Gjoks pule (rreth 160 g/6 oz)	1-5 copë	15-25	180°C/350°F	
Pulë e plotë	1200 g/42 oz	60-70	180°C/350°F	
Peshk i plotë (rreth 300-400 g/11-14 oz)	1-2 peshq	20-25	200°C/400°F	

Përbërësit	Sasia min.–maks.	Ora (min)	Temperatura	Shënim
Filetë peshku (rreth 200 g/7 oz)	1-5 (1 shtresë)	25-32	160°C / 325°F	
Perime të përziera (të prera trashë)	200-800 g/7-28 oz	9-18	180°C/350°F	• Caktoni kohën e gatimit sipas dëshirës • Tundini, kthejini ose trazojini deri në gjysmë
Kekë të vegjël (rreth 50 g/1.8 oz)	1-9	13-15	180°C/350°F	• Përdorni kupa kekësh të vegjël
Kek	500 g/18 oz	40-45	160°C/325°F	• Përdorni tepsi keku
Bukë/simite të paragatuara (rreth 60 g/ 2 oz)	1-6 copë	6-8	200°C/400°F	
Bukë shtëpie	800 g / 28 oz	55-65	150°C/300°F	• Përdorni aksesarin e pjekjes • Forma mund të jetë sa më e rrafshët të jetë e mundur për të parandaluar takimin e rezistencës nga buka gjatë fryrjes.

Skuqja me ajër




! Kujdes

- Kjo është një fritezë që punon me ajër të nxehtë. Mos e mbushni tiganin me vaj, yndyrë skuqjeje apo ndonjë lëng tjetër.
- Mos i prekni sipërfaqet e nxehta. Përdorni dorezat ose rrotullat. Kapeni tiganin e nxehtë me doreza të sigurta për furrë.
- Kjo pajisje është vetëm për përdorim shtëpiak.
- Kjo pajisje mund të lëshojë njëfarë tymi kur e përdorni për herë të parë. Kjo është normale.
- Nuk është e nevojshme që pajisja të ngrohet paraprakisht.

1 Futeni spinën në prizë.

14 SHQIP



- 2 Hiqeni tiganin me koshin nga pajisja duke tërhequr dorezën.




- 3 Vërini përbërësit në kosh.



Shënim

- Friteza mund të përgatisë një larmi të gjerë përbërësish. Shikoni "Tabelën e ushqimeve" për sasi të duhura dhe kohët e përafërta të gatimit.
- Mos e tejkaloni sasinë e përcaktuar në "Tabelën e ushqimeve" dhe mos e tejmbushni koshin përtej treguesit "MAX" pasi mund të ndikoni në cilësinë e rezultatit përfundimtar.
- Nëse dëshironi të përgatisni përbërës të ndryshëm njëherësh, sigurohuni të kontrolloni kohën e sugjeruar të gatimit të kërkuar për përbërës të ndryshëm përpara se të filloni t'i gatuar njëherësh.




- 4 Vendoseni tiganin me koshin sërish në fritezë.




Kujdes


- Mos e përdorni tiganin pa koshin brenda.
- Mos e prekni tiganin apo koshin gjatë dhe për njëfarë kohe pas përdorimit, pasi nxehen shumë.




- 5 Shtypni butonin e ndezjes/fikjes për të ndezur pajisjen.



- 6 Shtypni butonin e rritjes/uljes së temperaturës për të zgjedhur temperaturën e nevojshme.



- 7 Shtypni butonin e rritjes së kohës për të zgjedhur kohën e nevojshme.




- 8 Shtypni butonin e ndezjes/fikjes për të nisur procesin e gatimit.

Shënim

- Gjatë gatimit temperatura dhe koha shfaqen me alternim.
- Minuta e fundit e gatimit shfaqet me numërim mbrapsht të sekondave.
- Shihni tabelën e ushqimeve me cilësimet bazë të gatimit për lloje të ndryshme ushqimi.
- Kur fillon procesi i gatimit dhe friteza është e çftuar me pajisjen tuaj inteligjente, mund të shikoni, kontrolloni dhe ndryshoni parametrat e gatimit edhe në programin NutriU.
- **Për të ndryshuar njësinë e temperaturës nga celsius në farenajt ose anasjelltas te friteza, shtypni butonin e rritjes ose uljes së temperaturës njëherësh për rreth 10 sekonda.**

Këshillë

- Gjatë gatimit nëse dëshironi të ndryshoni kohën ose temperaturën e gatimit, shtypni butonin përkatës të rritjes ose uljes në çfarëdo kohe për ta bërë.
- Për të pushuar procesin e gatimit, shtypni butonin e ndezjes/fikjes. Për të rifilluar procesin e gatimit, shtypni sërish butonin e ndezjes/fikjes.
- Pajisja është automatikisht në modalitet pushimi kur nxirni jashtë tiganin dhe koshin. Procesi i gatimit vazhdon kur tigani dhe koshi rifuten në pajisje.




Shënim

- Nëse nuk e caktoni kohën e kërkuar të gatimit brenda 30 minutave, pajisja fiket automatikisht për arsye sigurie.
- Disa përbërë kërkojnë tundje ose kthim në gjysmën e kohës së gatimit (shikoni "Tabelën e ushqimeve"). Për të tundur përbërësit, nxirrni tiganin me koshin, vendosini në një sipërfaqe rezistente ndaj nxehtësisë, vendosni kapakun dhe shtypni butonin e lirimit të koshit për ta hequr koshin dhe për ta tundur mbi lavaman. Pastaj rifuteni koshin në tigan dhe vendosini sërish në pajisje.
- Nëse e caktoni kronometrin në gjysmën e kohës së gatimit dhe dëgjoni zilen e kronometrit është koha për të tundur ose kthyer përbërësit. Sigurohuni ta ricaktoni kronometrin për kohën e mbetur të gatimit.

9 Kur dëgjoni zilen e kronometrit, koha e gatimit ka përfunduar.

Shënim

- Mund ta ndaloni manualisht procesin e gatimit. Për ta bërë këtë, shtypni butonin e ndezjes/fikjes.




10 Nxirrni tiganin dhe kontrolloni nëse janë gati përbërësit.

Kujdes

- Tigani i fritezës është i nxehtë pas procesit të gatimit. Vendoseni gjithnjë në një sipërfaqe rezistente ndaj nxehtësisë (p.sh. këmbje etj.) kur e hiqni tiganin nga pajisja.

Shënim


- Nëse përbërësit nuk janë ende gati, thjesht futeni tiganin sërish në fritezë nga doreza dhe shtoi disa minuta të tjera mbi kohën e caktuar.




11 Për të hequr përbërësit e vegjël (p.sh. patatet e skuqura), ngrieni koshin jashtë tiganin duke rrëshqitur së pari kapakun dhe pastaj duke shtypur butonin e lirimit të koshit.

Kujdes

- Pas procesit të gatimit, tigani, koshi, hapësira e brendshme dhe përbërësit janë të nxehtë. Në varësi të llojit të përbërësve në fritezë, mund të dalë avull nga tigan.





12 Zbrazeni përmbajtjen e koshit në tas ose në një pjatë. Hiqeni gjithnjë koshin nga tigani për të zbrazur përmbajtjen, pasi mund të ketë vaj të nxehtë në fund të tiganit.

Shënim


- Për të hequr përbërës të mëdhenj ose të brishtë, përdorni një palë kapëse për ngritjen e përbërësve.
- Vaji i tepërt ose yndyra e përdorur nga përbërësit mbledhen në fund të tiganit.
- Në varësi të llojit të përbërësve në gatim, mund të dëshironi ta derdhni me kujdes vajin ose yndyrën e përdorur jashtë tiganit pas çdo grupi ose përpara tundjes a rifutjes së koshit në tigan. Vendoseni koshin në një sipërfaqe rezistente ndaj nxehtësisë. Mbani doreza të sigurt për furrë për derdhjen e tepicës së vajit apo yndyrës së përdorur. Kthejeni koshin në tigan.

Kur një grup përbërësish janë gati, friteza është në çast gati për të bërë grupin e radhës.


Shënim

- Përsërisni hapat 3 deri 12 nëse dëshironi të përgatitsni një grup tjetër.

Zgjidhni modalitetin e mbajtjes ngrohtë



1 Shtypni butonin e menysë aq herë sa të pulsojë ikona e mbajtjes ngrohtë.



2 Shtypni butonin e ndezjes/fikjes për të nisur modalitetin e mbajtjes ngrohtë.

Shënim

- Kronometri i mbajtjes ngrohtë caktohet në 30 minuta. Për të ndryshuar kohën e mbajtjes ngrohtë (1–30 minuta), shtypni butonin e uljes së kohës. Koha do të konfirmohet automatikisht.
- Temperatura nuk mund të ndryshohet në modalitetin me mbajtjes ngrohtë.

- 3 Për ta pushuar modalitetin e mbajtjes ngrohtë, shtypni butonin e ndezjes/fikjes. Për të rinisur modalitetin e mbajtjes ngrohtë, shtypni sërish butonin e ndezjes/fikjes.
- 4 Për të dalë nga modaliteti i mbajtjes ngrohtë, shtypni gjatë butonin e ndezjes/fikjes.


Këshillë

- Nëse ushqimet si patatet e skuqura humbasin vetinë krokante gjatë modalitetit të mbajtjes ngrohtë, ose shkurtoni kohën e mbajtjes ngrohtë duke e fikur pajisjen më herët ose bëjini krokante për 2-3 minuta në temperaturë 180°C/350°F.


Shënim

- Gjatë modalitetit të mbajtjes ngrohtë, ventilatori dhe ngrohësi brenda pajisjes ndizen herë pas here.
- Modaliteti i mbajtjes ngrohtë është projektuar për mbajtjen ngrohtë të ushqimit menjëherë pas gatimit me fritezë. Nuk synohet për ringrohje ushqimi.

Gatimi me presete



- 1 Ndiqni hapat 1 deri 5 në kapitullin "Skuqja me ajër".
- 2 Shtypni butonin e menysë. Pulson ikona e ushqimeve të ngrira. Shtypni butonin e menysë aq herë sa të pulsojë preseti i dëshiruar.




- 3 Filloni procesin e gatimit duke shtypur butonin e ndezjes/fikjes.

Shënim


- Në tabelën e mëposhtme mund të gjeni më shumë informacion për presetet.

Preset (Paravendos)	Koha e presetit (min)	Temperatura e presetit	Pesha (maks.)	Informacion
 Ushqime çasti me bazë patatesh të ngrira	31	180°C/ 350°F	800 g/28 oz	- Ushqime çasti me bazë patatesh të ngrira, si p.sh. patate të ngrira për skuqje, copa patatesh, patate të valëzuara etj. - Tundini, kthejini ose trazojini 2-3 herë ndërmjet
 Patate të freskëta	38	180°C/ 350°F	800 g/28 oz	- Përdorni patate miellëse 10x10mm / 0.4x0.4 në prerje të trashë - Zhytini 30 minuta në ujë, thajini dhe pastaj shtoni ¼ deri 1 lugë gjelle vaj - Tundini, kthejini ose trazojini 2-3 herë ndërmjet
 Kofshë pule	27	180°C/ 350°F	1000 g/35 oz	- Deri në 8 kofshë pule - Tundini, kthejini ose trazojini ndërmjet
 Peshk i plotë rreth 300 g/11 oz	20	200°C/ 400°F	600 g/21 oz	
 Kek	45	160°C/ 325°F	500 g/18 oz	Përdorni aksesorin e pjekjes XL (199 x 189 x 80 mm)
 Thela mishi	20	200°C/ 400°F	600 g/21 oz	Deri në 4 thela mishi pa kockë
 Perime të përziera	18	180°C/ 350°F	800 g/28 oz	- Të prera trashë - Përdorni aksesorin e pjekjes XL
 Mbajeni ngrohtë	30	80°C/ 175°F	N/A	Temperatura nuk mund të rregullohet


Kalimi në preset tjetër




- 1 Gjatë procesit të gatimit shtypni gjatë butonin e ndezjes/fikjes për të ndaluar procesin e gatimit. Pajisja kalon pastaj në modalitetin pasiv.



- 2 Shtypni sërish butonin e ndezjes/fikjes për të ndezur pajisjen.



- 3 Shtypni butonin e menysë aq shpesh sa pulson preseti që ju duhet.



- 4 Shtypni butonin e ndezjes/fikjes për të nisur procesin e gatimit.

Nisja e një recete nga programi NutriU

- 1 Shtypni butonin e ndezjes/fikjes për të ndezur fritezën.
- 2 Hapni programin NutriU në pajisjen tuaj inteligjente dhe shikoni për recetën e preferuar.
- 3 Hapni recetën dhe nisni procesin e gatimit në program.



Shënim

- Sigurohuni që gjatë gatimit recetat që janë hartuar për fritezën tuaj të përdorin të njëjtat sasi ushqimi të përmendura në to. Kur përdorni përbërës të tjerë apo sasi të tjera për ushqimet, rregulloni kohën e gatimit. Kur gatvani receta që nuk janë hartuar për fritezën tuaj, vini re se mund të nevojitet rregullimi i kohës dhe i temperaturës.



Këshillë

- Përmes filtrit në kërkimit e recetave mund ta filtroni fritezën për të marrë recetat që janë hartuar për pajisjen tuaj.
- Kur procesi i gatimit nisët nga programi, mund t'i shikoni cilësimet e gatimit dhe në ekranin e fritezës.
- Mund ta pushoni procesin e gatimit ose të ndryshoni cilësimet në fritezë ose në program.
- Kur të mbarojë procesi i gatimit, mund të nisni modalitetin e mbajtjes ngrohtë në program ose ta nisni nga preseti "keep warm" në fritezë.
- Nëse ushqimi nuk është bërë ende, mund dhe ta zgjasni procesin e gatimit brenda aplikacionit ose në fritezë.
- Për të dalë nga procesi i gatimit përpara se të mbarojë koha e gatimit, shtypni gjatë butonin e ndezjes/fikjes në fritezë ose shtypni ikonën e pushimit dhe pastaj të ndalimit në program.
- Mund dhe të nisni kohën tuaj individuale dhe temperaturën në programin NutriU.
- Në fund të ekranit kryesor ka një buton për të kaluar në ekranin kryesor, recetat, modalitetin manual, artikujt ose profilin tuaj. Shtypni butonin e modalitetit manual dhe dërgoni kohën dhe temperaturën tuaj individuale te friteza.

Skuqja e patateve të shtëpisë

Për patate fantastike shtëpie në fritezë:

- Zgjidhni një varietete patatesh të përshtatshme për skuqje, p.sh. patate të freskëta, (pak) miellëse.
- Është më mirë t'i skuqni patatet me ajër në racione deri 800 g/28 oz për rezultat të njëtrajtshëm. Patatet e mëdha piren të jenë më pak krokante se të voglat.

- 1 Qërojini patatet dhe pritini të holla (10 x 10 mm/0.4 x 0.4 trashësi).**
- 2 Njomini patatet e prera në një tas me ujë për të paktën 30 minuta.**
- 3 Zbrazeni tasin dhe thajini patatet e prera me një pecetë enësh ose letre.**
- 4 Hidhni një lugë gjelle vaj gatimi në tas, vendosini patatet në tas dhe trazojini derisa patatet të vishen me vaj.**
- 5 Hiqini patatet nga tasi me gishta ose një kapëse kulluese që vaji të mbetet në tas.**



Shënim

- Mos e anoni tasin për t'i hedhur të gjitha patatet e prera njëherësh në kosh, që të evitoni derdhjen e vajit të tepërt në tigan.

6 Hidhini patatet e prera në kosh.

7 Skuqini patatet e prera dhe tundeni koshin 2-3 herë gjatë gatimit.

Pastrimi



Paralajmërim

- Lëreni koshin, tiganin dhe brendësinë e pajisjes që të ftohet plotësisht përpara se të filloni pastrimin.
- Tigani, koshi dhe brendësia e pajisjes kanë një veshje jongjitëse. Mos përdorni enë kuzhine metalike ose materiale gërryese pastrimi, pasi mund të dëmtoni veshjen jongjitëse.

Pastroni pajisjen pas çdo përdorimi. Hiqni vajin dhe yndyrën nga fundi i tiganit pas çdo përdorimi.

1 Shtypni butonin On/Off për të fikur pajisjen hiqeni nga priza dhe lëreni të ftohet.



Këshillë

- Hiqni tiganin dhe koshin për ta lënë fritezën të ftohet më shpejt.

2 Hidheni yndyrën ose vajin e përdorur nga fundi i tiganit.

3 Pastrojeni tiganin dhe koshin në enëlarëse. Gjithashtu mund t'i pastroni me ujë të nxehtë, solucion për larjen e enëve dhe një sfungjer jogërryese (shihni "Tabelën e pastrimit").




Shënim


- Vëreni tiganin me tapën e gomës në enëlarëse. Mos e hiqni tapën e gomës përpara pastrimit.



Këshillë

- Nëse mbetjet e ushqimit ngjisin në tigan apo kosh, mund t'i njomni me ujë të nxehtë dhe detergjent enësh për 10-15 minuta. Njomja i liron mbetjet ushqimore dhe lehtëson heqjen e tyre. Sigurohuni që të përdorni një lëng larës që mund të shpërbëjë vajin dhe yndyrën. Nëse ka njolla yndyre në tigan ose në kosh dhe nuk keni pasur mundësi t'i hiqni me ujë të nxehtë dhe detergjent enësh, përdorni sgrasator.
- Nëse është nevoja, mbetjet ushqimore të ngjitura pas rezistencës mund të hiqen me një furçë me fije të vuta deri mesatare. Mos përdorni furçë me tel apo me fije të forta, pasi mund të dëmtoni veshjen e rezistencës.






4 Fshijeni pjesën e jashtme të pajisjes me një leckë të njomë.




Shënim

- Sigurohuni që të mos mbetet lagështi mbi panelin e kontrollit. Thani panelin e kontrollit me një leckë pasi ta keni pastruar.




5 Pastrojeni rezistencën me një furçë pastrimi për të hequr mbetjet e mundshme të ushqimit.



6 Pastrojeni brendësinë e pajisjes me ujë të nxehtë dhe fungjer jogërres.

Tryeza e pastrimit

			
	✓	✓	✗
	✓	✓	✗

Vendruajtja


- 1 Hiqeni pajisjen nga priza dhe lëreni të ftohet.
- 2 Sigurohuni që të gjitha pjesët të jenë të pastra dhe të thata përpara se t'i ruani.



Shënim

- Mbajeni gjithmonë fritezën horizontalisht kur e transportoni. Sigurohuni gjithashtu që ta mbani tiganin në pjesën e parme të pajisjes pasi tigani me koshin mund të rrëshqasë jashtë pajisjes nëse anohet gabimisht për poshtë. Kjo mund të sjellë dëmtimin e këtyre pjesëve.
- Sigurohuni gjithnjë që pjesët e heqshme të fritezës të fiksohen përpara se ta transportoni dhe/ose magazinoni.

Riciklimi



- Ky simbol do të thotë që produkti nuk duhet të hidhet me mbeturinat normale të shtëpisë (2012/19/BE).
- Ndiqni rregullat shtetërore për hedhjen e veçuar të produkteve elektrike dhe elektronike. Hedhja e duhur ndihmon në parandalimin e pasojave negative ndaj mjedisit dhe shëndetit të njeriut.

Deklarata e konformitetit

Nëpërmjet këtij dokumenti, DAP B.V. deklaron se friteza me ajër "HD928x" është në përputhje me Direktivën 2014/53/BE.

Teksti i plotë i deklaratës së konformitetit të BE-së gjendet në adresën e mëposhtme të internetit: <https://www.philips.com>. Friteza me ajër HD928x është e pajisur me një modul Wi-Fi, 2,4 GHz 802.11 b/g/n me një fuqi maksimale dalëse prej 92,9 mW EIRP.

Garancia dhe mbështetja

Nëse ju duhet informacion apo mbështetje teknike, vizitoni **www.philips.com/support** ose lexoni fletëpalosjen e posaçme të garancisë botërore.

Përditësimet e softuerit

Përditësimi është thelbësor për të garantuar privatësinë tuaj dhe funksionimin e duhur të fritezës me ajër dhe të aplikacionit. Hera-herës, aplikacioni përditësohet automatikisht me softuerin më të fundit. Gjithashtu, friteza me ajër përditëson firmuerin në mënyrë automatike.



Shënim

- Gjatë instalimit të një përditësimi, sigurohuni që friteza të jetë e lidhur me rrjetin Wi-Fi të shtëpisë. Pajisja inteligjente mund të lidhet me çfarëdo rrjeti.
- Përdorni gjithmonë aplikacionin dhe firmuerin më të fundit.
- Përditësimet bëhen të disponueshme kur ka përmirësime të softuerit apo për të parandaluar një problem me sigurinë.
- Përditësimi i firmuerit nis automatikisht kur friteza me ajër është në modalitetin e pritjes. Ky përditësim zgjat deri në 1 minutë dhe ekrani i fritezës tregon "---" me pulsime. Gjatë kësaj kohe friteza me ajër nuk mund të përdoret.

Përputhshmëria e pajisjes

Për informacione të detajuara mbi përputhshmërinë e aplikacionit, referojuni informacionit në "App Store".

Rikthimi në parametrat e fabrikës

Për ta rikthyer fritezën me ajër në parametrat e fabrikës, mbani njëkohësisht shtypur butonat e temperaturës dhe të mbarimit të kohës për 10 sekonda.

Pas kësaj, friteza me ajër nuk është më e lidhur me rrjetin Wi-Fi të shtëpisë suaj dhe nuk është më e çiftuar me pajisjen tuaj inteligjente.

Zgjidhja e problemeve

Ky kapitull përmbledh problemet më të shpeshta që mund të hasni me pajisjen. Nëse nuk keni mundësi ta zgjidhni problemin me informacionin e mëposhtëm, vizitoni **www.philips.com/support** për një listë të pyetjeve të shpeshta ose kontaktoni me qendrën e shërbimit të klientit për shtetin tuaj.

Problemi	Shkaku i mundshëm	Zgjidhja
Pjesa e jashtme e pajisjes nxehet gjatë përdorimit.	Nxehtësia brenda rrezaton në muret e jashtme.	Kjo është normale. Të gjitha dorezat dhe pullat që duhet të preknin gjatë përdorimit qëndrojnë mjaftueshëm të ftohta për t'i prekur.
		Tigani, koshi dhe brendësia e pajisjes mund të nxehen gjithnjë kur pajisja ndizet për t'u siguruar që ushqimi të gatuhet siç duhet. Këto pjesë janë gjithmonë shumë të nxehta për t'u prekur.

Problemi	Shkaku i mundshëm	Zgjidhja
		Nëse e lini pajisjen të ndezur për një kohë më të gjatë, disa zona nxehen shumë për t'u prekur. Këto zona janë shënuar në pajisje me ikonën e mëposhtme:  Për sa kohë që jeni të vetëdijshëm për zonat e nxehta dhe shmangni prekjen e tyre, pajisja është plotësisht e sigurt për t'u përdorur.
Patatet e skuqura të shtëpisë nuk dalin ashtu siç i prisja.	Nuk keni përdorur llojin e duhur të patateve.	Për rezultate optimale, përdorni patate të freskëta miellëse. Nëse ju duhet t'i ruani patatet për më vonë, mos i mbani në ambient të ftohtë, si p.sh. frigoriferi. Zgjidhni patate paketimi i të cilave pohon se janë të përshtatshme për skuqje.
	Sasia e përbërësve në kosh është shumë e madhe.	Ndiqui udhëzimet në faqen 21 e këtij manuali përdorimi, për të përgatitur patate të skuqura shtëpie.
	Përbërës të llojeve të caktuara mund të jetë nevoja të tunden deri në gjysmën e kohës së gatimit.	Ndiqui udhëzimet në faqen 21 e këtij manuali përdorimi, për të përgatitur patate të skuqura shtëpie.
Friteza nuk ndizet.	Pajisja nuk është në prizë.	Kontrolloni nëse spina është futur siç duhet në prizën e murit.
	Disa pajisje janë të lidhura në një prizë.	Friteza ka fuqi të lartë. Provoni një prizë tjetër dhe kontrolloni siguresat.
Dalloj disa zona të rrjepura brenda fritezës sime.	Disa njolla të vogla mund të shfaqen brenda tiganit të fritezës për shkak të prekjes ose gërvishtjes së rastësishme të veshjes (p.sh. gjatë pastrimit me mjete të forta pastrimi dhe/ose gjatë futjes së koshit).	Mund ta parandaloni dëmtimin duke e ulur me kujdes koshin në tigan. Nëse e futni koshin me kënd, ana e tij mund të përpiqet kundër mureve të tiganit duke shkaktuar ciflosjen e veshjes. Nëse ndodh diçka e tillë, vini re se kjo nuk është e rrezikshme pasi të gjitha materialet e përdorura janë të sigurta për përdorim ushqimor.
Del tym i bardhë nga pajisja.	Po gatuani përbërës të yndyrshëm.	Derdheni me kujdes tepricën e vajit ose të yndyrës nga tigani dhe vazhdoni me gatimin.
	Tigani përmban ende mbetje të yndyrshme nga përdorimi i mëparshëm.	Tymi i bardhë shkaktohet nga mbetjet e yndyrshme që ngrohin tiganin. Pastrojeni gjithnjë me kujdes tiganin dhe koshin pas çdo përdorimi.

Problemi	Shkaku i mundshëm	Zgjidhja
	Buka ose kuvertura nuk ngjitet mirë me ushqimin.	Thërrime të vogla buke mund të shkaktojnë tym të bardhë. Shtypeni mirë mbulimin me bukë ose kuverturën me ushqimin për t'u siguruar që të ngjisin.
	Marinadat, lëngjet e ndryshme ose të mishit spërkaten në yndyrën e përdorur.	Takojeni ushqimin derisa të thahet përpara se ta vendosni në kosh.
Llamba e Wi-Fi në fritezën time nuk ndizet më.	- Friteza nuk është më e lidhur me Wi-Fi të shtëpisë. - Keni ndryshuar rrjetin Wi-Fi të shtëpisë.	Nisni procesin e konfigurimit të Wi-Fi duke shtypur gjatë butonin e menysë dhe ndiqni udhëzimet në program.
Programi tregon se procesi i çiftimit nuk është i suksesshëm.	Një përdorues tjetër e ka çiftuar fritezën me një pajisje tjetër inteligjente dhe është duke gatuar.	Prisni derisa përdoruesi tjetër të ketë përfunduar procesin aktual të gatimit dhe riçiftojeni pajisjen inteligjente me fritezën.
Ekrani im tregon "----" me pulsime.	Friteza po përditëson firmuerin.	Prisni për një minutë sa të përfundojë procesi i përditësimit të firmuerit. Nuk mund ta përdorni fritezën gjatë përditësimit të firmuerit.
Ekrani i fritezës tregon "E1".	Pajisja është prishur/ka defekt.	Telefononi linjën e shërbimit të Philips ose qendrën e shërbimit të klientit për shtetin ku ndodhni.
	Friteza mund të ruhet në një vend ku bën shumë ftohtë.	Nëse e keni mbajtur pajisjen diku me temperaturë të ulët ambientit, lëreni të vijë në temperaturën e ambientit të ri për të paktën 15 minuta përpara se ta fusni në prizë. Nëse ekrani vazhdon të tregojë "E1", telefonojini linjës së shërbimit të Philips ose kontaktoni me qendrën e shërbimit të klientit për shtetin ku ndodhni.

